REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERIT TIRANE
NR. 401 REP.
NR. 59 KOL

## KONTRAT SHITBLERJE
## KUOTASH KAPITALIT THEMELTAR

Sot me date 19.03.2001, dymije e nji, u paraqiten para meje noteres, ne Tirane, palet si me poshte

**SHITESAT :**

1.- ***Jani Qose***, e banues ne Ura Vajgurore Berat, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, me identitete te njohur nepermjet leternjoftimit perkates.

2.- ***Llazar Mafiqi***, e me banim ne Berat – Ura Vajgurore, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, i njohur nepermjet leternjoftimit perkatese

**BLERESI**

***Koci Ismaili***, lindur dhe banues ne Berat, madhor dhe me zotesi te plote juridike per vepruar, i njohur nepermjet leternjoftimit perkatese.

Te cilet lidhin kete kontrate shitblerje te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise **" KOLOSEU "** SHPK, si me poshte :

Shitesat Z. Jani Qose dhe Llazar Mafiqi, jane pronar I 100%te kuotes te kapitalit themeltar te shoqerise "KOLOSEU " shpk. Me vlere me 50 me 50 % sejcili prej tyre kjo ne baze te vendimit gjyqesor nr. 9794 date 21.03.1995 te Gjykates se rrethit Tirane .per regjistrmit e personit juridik .

Shitesat e mesiperme 25% te kuotes kapitalit themeltar me vlere 25,000eke ja shet bleresit Koci Ismailit kundrejte cmimit te shites., ngelet 37.500leke sejcilit 37.5%

Bleresi, deklaron se eshte dakorte te blej kete kuote prej 25 % te kapitalit themeltar te shoqerise " KOLOSEU " shpk, ku sejcili ortak i shet 12.5% te kuotave

Palet deklarojne se me likujdimin teresisht te vleres se mesiperme te cmimit te shitjes dhe me nenshkrimin e kesaj kontrate noteriale prej tyre shitesi Jani Qose dhe Llazar Mafiqi, zhvishen nga e drejta e pronesise per kuoten 25% te kapitalit themeltar dhe bleresi z. Koci Ismaili, behet pronar I kuotes 25% te kapitalit themeltar te shoqerise "KOLOSEU "shpk, duke u bere tre ortak te kesaj shoqerie te pershkruar me larte.

Kontrata e mesiperme, pasi u perpilua u lezua nga palet dhe pasi u gjend ne vullnetin e tyre te lire dhe te plote, nenshkruan rregullisht perpara meje dhe une notere e vertetoj ate sips ligjit .

**SHITESAT** **BLERESI**

Jani Qose Llazar Mafiqi Koci Ismaili

**NOTERE :**

Halixhe Gjoni

PULLE TAKSE
100 LEKE
R. SHQIPERISE